



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK

BULETINI JAVOR I SËMUNDSHMËRISË INFEKTIVE - ALERT

JAVA 21 20 – 26 Maj 2024

Për këtë periudhë, kanë raportuar 36 NJVKSH ose 100% (=36/36) e tyre

36 NJVKSH ose 100% (=34/36) e tyre kanë raportuar në platformën dixhitale SISI:

BERAT, BULQIZË, DEVOLL, DIBËR, DURRËS, ELBASAN, FIER, GJIROKASTËR, GRAMSH, HAS, KAVAJË, KOLONJË, KORÇË, KRUIJË, KUÇOVË, KUKËS, KURBIN, LEZHË, LIBRAZHD, LUSHNJE, MALLAKASTËR, M. MADHE, MAT, MIRDITË, PEQIN, PËRMET, POGRADEC, PUKË, SARANDË, SHKODËR, SKRAPAR, TEPELENË, TIRANË, TROPOJË, VLORË.

Pa raportim brenda afatit, 0 NJVKSH ose 0% (=0/36) e tyre:

NUMRI TOTAL I RASTEVE TË SINDROMAVE TË SURVEJANCËS "ALERT" NË JAVËN 21

	JAVA 21
DIARRE PA GJAK	1.420
DIARRE ME GJAK	0
INF. RESP. TE SIPËRME	7.355
INF. RESP. TE POSHTËME	2.971
RASH ME TEMPERATURË	33
VERDHEZA	0
ETHE E ZGJATUR E PASHPJEGUAR (> 3 JAVE)	0
ANOMALI KONGENITALE	0
KONJUKTIVIT AKUT TEK NEONATËT	0
Numri i Njësive Raportuese	424
% e Njësive Raportuese	96% (424/442)

Rash me temperaturë

Nga hetimi epidemiologjik dhe konsultat me mjekët e familjes, mjekun infeksionist dhe atë epidemiolog rastet e mëposhtëme nuk janë të dyshuar për fruth, rubeolë apo linë e majmunit, por për varicelë dhe dorë-këmbë-gojë:

Durrës – 3 raste

Kavajë – 2 raste

Lushnje – 1 rast


Pogradec – 1 rast

Tiranë – 15 raste


Vlorë – 11 raste

Infeksione respiratore

Trendi në kohë i Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme sipas javëve




Shpërndarja e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme sipas Grup-moshave




Prirja në kohë e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme paraqet rënie në javën 21 krahasuar me javën paraardhëse, java 20.

Diarre pa gjak

Trendi në kohë i Diarreve pa Gjak sipas javëve




Shpërndarja e Diarreve pa Gjak sipas Grup-moshave




Prirja në kohë e “Diarreve pa gjak” paraqet ritje në javën 21 krahasuar me javën paraardhëse, java 20.

Prirja e “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” në javët 10 – 21 të viteve 2023 dhe 2024. Numri i rasteve.




Në javën 21 të vitit 2024 vërehet prirje në rënie e numrit të infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme.


Frekuenca e “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas grupmoshës. Incidenca (raste/10.000)



Frekuenca e hasjes së “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas NJVKSH në javën 20 dhe 21 / 2024. Incidenca (raste/10.000)




Prirja e “Diarreve pa Gjak” në javët në javët 10 - 21 të viteve 2023 dhe 2024. Numri i rasteve.



Në javën 21 të vitit 2024 vërehet e prirje në ritje e numrit të rasteve “Diarre pa gjak”.

Frekuenca e hasjes së “Diarreve pa gjak” sipas NJVKSH në javën 20 dhe 21 / 2024.
Incidenca (raste/10.000)



Nga komunikimi me NJVKSH shumica e rasteve janë raportuar nga Urgjenca e Spitaleve dhe janë të shpërndara, pa grumbullime dhe lidhje epidemiologjike ndërmjet tyre.

Ngjarje kombëtare

1. Fruthi, situatë epidemiologjike (Shtojca 2)

- Për periudhën Janar – 28 maj 2024 janë testuar 183 raste të dyshuar me fruth nga të cilët janë konfirmuar 40 (21.8%) raste me Fruth.
- Nga keto 37 raste janë konfirmuar në laboratorin kombëtar të referencës të virologjisë në ISHP dhe 3 raste janë të konfirmuar sipas perkufizimit të rastit mbeshtetur në shenjat klinike dhe epidemiologjike.
- Incidenca e sëmundjes në vend është 1.4 raste/100 000 banorë.
- Rastet i perkasin moshes nga 0-38 vjec (mediana 5 vjec).
- Numri më i lartë i perkët grupmoshes 5-9 vjec me 30% të totalit të rasteve të konfirmuar
- Incidenca më e lartë është në grupmoshën 2-4 vjec me 14.7 raste/100 000 banorë.
- Nga 40 rastet e konfirmuar 22 (55%) prej tyre janë shtruar në spital dhe 18 raste (45%) kanë qëndruar në kushte shtëpie.
- 22 raste janë të pavaksinuar (55%) dhe 18 raste (45%) janë të vaksinuar me të paktën një dozë vaksine.
- Numri më i lartë i rasteve i perkët Tiranës 27 raste ose 67.5% e totalit.
- Incidencën më të lartë e ka Durrësi me 4.7 raste/100 000 banorë.

2. Rast i dyshuar me sindromën Dore-Kembe -Goje- Kucove

- Rasti i datelindjes 19.11.202, mashkull, banor në Kucovë është referuar nga mjekja e familjes si i dyshuar me sindromën dore- kembe-goje.
- Shenjat klinike: elemente kutane me ngjyrë të kuqe të lokalizuara në gojë, duar dhe kembe të shoqëruara me temperaturë, data e fillimit të shenjave 20.05.2024.
- Femija shkon në qendër, grupi i të cilit përbehet nga 15 femije.
- Nga hetimi epidemiologjik rezulton se asnjë femije nuk ka paraqitur shenja të ngjashme.
- Po ashtu edhe familjarët janë pa shenja klinike.
- Femija ka qëndruar në shtëpi, në monitorim nga mjekja e familjes.
- U rekomandua marrja e mostres për të testuar pranë laboratorit në ISHP nëse shfaqen raste të tjera të dyshuar me këtë sindromë.

3. Raste të dyshuara me Zgjebe- Sarandë

- Rastet janë raportuar nga mjekja e familjes në QSH Vrinë
- Të 6 rastet e dyshuara janë femije të shkollës 9 vjeçare, Vrinë.

- Pas hetimit epidemiologjik ne vater u rekomandua:
- Ndjekje e rasteve nga infermierja e QSH Vrine dhe monitorim ne vazhdimesi ne shkolle.
- Referim te mjeku I familjes nese konstatohen raste te tjera.
- Rekomandim per zbatimin e rregullave te ndjekjes se higjenes personale.
- U krye dezinfektimi i shkolles dhe ajrosja e klasave.
- Monitorim i vazhdushem nga grupi i punes se NJVKSH Sarande deri ne perfundimin e vates.

Ngjarje ndërkombëtare

4. Kolera –Monitorimi i shpërthimeve globale – Përditësimi mujor

- Në prill 2024, 52 526 raste të reja të kolerës, përfshirë 529 vdekje të reja, u raportuan në mbarë botën. Që nga 1 Janar 2024 dhe deri më 30 Prill 2024, janë raportuar 150 866 raste kolera, duke përfshirë 1 775 vdekje botëror.
- Raste të reja u raportuan nga Afganistani, Bangladeshi, Brazili, Burundi, Komoret, Republika Demokratike eKongoja, Etiopia, Haiti, India, Kenia, Malavi, Mozambiku, Nigeria, Pakistani, Somalia, Afrika e Jugut, Sudani, Siria, Tajlanda, Republika e Bashkuar e Tanzanisë, Jemeni, Zambia dhe Zimbabve.
- Rastet e kolerës kanë vazhduar të raportohen në Afrikën perëndimore, lindore dhe jugore, disa pjesë tëLindja e Mesme, Azia dhe Amerika.
- Rreziku i infeksionit të kolerës tek udhëtarët që vizitojnë këto vende mbetet i ulët, edhe pse është i mundur importimi sporadik i rasteve në BE/ZEE.